



Jeta pas vdekjes në perspektivën islame

Description

Yahya Michot

Të shumta janë mënyrat se si teologët, filozofët, mjeshtrit shpirtërorë dhe mendimtarë të tjerë islam, klasik dhe bashkëkohorë, i janë qasur të dhënave eskatologjike shpesh sugjестive të cilat gjenden në Kuran dhe në traditën profetike. Si në mospërputhjet ashtu edhe në ngjashmëritë e tyre, siç do të tregojë edhe kjo ese, këto këndvështrime janë ndihmesa në kuptimin jo vetëm të frikërave dhe shpresave të myslimanëve, por edhe të konceptit të tyre për Zotin dhe njerëzimin.

Dyshimet dhe siguritë

Në një nga veprat e tij më të diskutuara, Avicena (vd. 1037) ka zhvilluar një hermeneutikë e cila e dërgoi atë drejt dyshimit se Kurani, gjatë shtjellimit të temave të tilla si bota tjetër, parajsja dhe zjarri i ferrit, ka ndërtuar dhe përligjur një doktrinë teologjike të ringjalljes trupore, të mundimeve apo kënaqësive mishore pas vdekjes.

“Si mund të jetë kuptimi literal i ligjit një argument në këto çështje [d.m.th. në çështjet e botës tjetër, ringjalljes së trupave, parajsës apo ferrit]? Nëse ne supozojmë se çështjet e botës tjetër janë spirituale, jo trupore, dhe thelbi i vërtetë i tyre është shumë larg perceptimit apriori nga mendja njerëzore, atëherë mënyra e ndjekur nga ligji religjioz për ti thirrur njerëzit drejt pranimit të këtyre [çështjeve shpirtërore] dhe për ti paralajmëruar rreth tyre nuk qëndron në tërheqjen e vëmendjes së njerëzve duke pajisur evidence rreth këtyre çështjeve, por duke i shprehur ato përmes një sërë shëmbëlltyrash (*temthil*) të cilat i dërgojnë këto çështje më pranë mendjes së njerëzore. Si mund atëherë të jetë ekzistenca e një gjëje[1] një argument në favor të ekzistencës së një tjetër gjëje[2] kur, nëse kjo gjëja tjetër do të zhdukej ashtu siç supozohet se do të ndodhë [3], gjëja e parë do të vazhdojë të qëndroj ashtu siç është? Gjithçka që thamë shërben për ti bërë të njohur, dikujt i cili është duke pritur që të bëhetanëtarë i elitës (*khas*) së njerëzimit dhe jo i njerëzve të thjeshtë, se kuptimi literal i ligjit religjioz nuk mund të përdoret si argument në çështje si këto të lartpërmendurat.” [4]

Për këtë filozof të madh Iranian, teologët myslimanë gabojnë kur e mbështesin këndvështrimin eskatologjik të tyre mbi leximin literal të revelatës. Kjo për arsye se qëllimi i saj themelor nuk është të mësoj një eskatologji të tillë, por përkundrazi të udhëzojë masat, ose me fjalë të tjera, të nxisë dhe mbajë stabilitetin brenda shoqërisë njerëzore duke frikësuar njerëzit me kërcënime dhe duke i joshur ato me premtime. Njësoj si, duke përdorur një shembull çfarëdo, një gomar drejtohet për në rrugën e saktë përmes karrotave dhe bastunit [5].”Nga e gjithë kjo duket se ligji religjioz i drejtohet masave rreth çështjeve që ata njohin, duke i sjellë gjërat që ato nuk i kuptojnë afër aftësive të tyre të përllogaritura përmes sjelljes së shëmbëlltyrave (*temthil*) dhe ngjashmërive (*teshbih*). Nëse çështja do të ishte ndryshe [nga kjo që sapo thamë], atëherë ligji religjioz do të ishte krejtësisht i padobishëm” [6]

Siç shpjegon dhe vetë Avicena, filozofia vërteton pamundësinë e rikthimit (*ma’ad*) fizik të trupave, si edhe natyrën pastërtish jomateriale të shpirtit njerëzor, pavdekshmërinë e tij, dhe superioritetin e pamasë të kënaqësive apo vuajtjeve shpirtërore karshi atyre trupore. Elita e atyre të cilët zotërojnë dije nuk janë të interesuar nga premtimet dhe kërcënimet e eskatologjisë kuranore, në të cilat, në rastin më të mirë, ato shohin vetëm imazhe dhe alegori të realiteteve të kuptueshme ndaj të cilave arsyeja i jep atyre akses. Për sa i përket masave të cilat ndjekin kuptimin literal të revelatës duke mos pasur aspak idenë për kuptimin që ka ajo për filozofët, sa më shumë që ti qëndrojnë pranë kuptimit literal aq më mirë është, sepse kjo siguron paqen dhe rendin shoqërorë. Duke qenë kështu, profeti, misioni i të cilit nisur nga ky këndvështrim u shenjua nga një sukses i plotë për faktin se përshkrimet e tij për botën tjetër ishin më të pranueshme nga masat se përshkrimet e çdo mesazhi tjetër religjioz, nuk mund të quhet një gënjeshtarë. Kur vdesin, njerëzit e thjeshtë dhe naiv në të vërtetë jetojnë në imagjinatë gjithçka të cilën ata e kanë besuar: parajsën, ferrin, etj., njësoj si në ëndrra. Dhe ne e dimë se sa të vërteta mund të jenë, brenda gjumit, ëndrrat apo makthet. [7]

Në librin e tij të famshëm “Vetëshkatërimi i filozofëve” (*Tehafut el-felasifeh*), një nga tre doktrinat për të cilat Gazaliu (vd. 1111) – i njohur si Agazel për mesjetarët latin- e dënoi Avicenën e të tjerë të ngjashëm me të ishte pikërisht “mohimi i tyre i ringjalljes trupore, mohimi i kënaqësive trupore të Parajsës apo vuajtjeve trupore të ferrit, si edhe mohimi i tyre i ekzistencës së ferrit dhe parajsës ashtu siç përshkruhen në Kuran” [8] Dikush mund të pyes veten se ç’mbetet nga mesazhi i profetit në eskatologjinë dybinarëshe të filozofëve, pastërtish jomateriale për elitën dhe imagjinare për *vulgum pecus*.

Veçanërisht të gjalla janë përshkrimet kuranore, të traditave profetike dhe të veprave të para të besimit

(akide) të përpiluara gjatë periudhës klasike islame, për botën tjetër, marrjen në pyetje në varr, ringjalljen e trupave, Ditën e Gjykimit, vuajtjet e ferrit dhe kënaqësitë e parajsës. [9]

Gjendja midis vdekjes dhe ringjalljes, ndërkohë që trupi qëndron në varr, është përshkruar si një barrierë apo një perde (*berzakh*): “E pastaj e vdes dhe i cakton një varr, dhe, kur të dojë, Ai e ringjall” “Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse (jeta e varrit), deri në ditën kur do të ringjallen” [10]

Sipas një prej veprave hanbelite të hershme për besimin, të riprodhuar nga Ibn El-Farra (vd. 1066), “dënimi i varrit është një realitet; individi do të pyetet rreth fesë dhe Zotit të tij dhe rreth parajsës dhe ferrit. Munkerit dhe Nekirit janë një realitet; ato janë dy engjëjt që do marrin në pyetje njerëzit në varr” [11]

Emrat e Ditës së Ringjalljes janë të shumtë: “Dita e Kiametit” (*jeumul kijameh*), “Ora” (*el-saa*), “Dita e Gjykimit” (*jeumudin*), “Dita e llogarisë” (*jeumul hisab*), “Dita e fundit” (*jeumul akhir*), etj. Kjo ditë do të jetë kataklizëm e paimagjinueshme dhe nuk ka dyshim se ajo do ndodhë vërtet.

“Në të vërtetë, ajo që u është premtuar, do të bëhet! Kur yjet të shuhën dhe, kur qielli të çahet dhe, kur malet të thërrmohen si pluhur dhe, kur të dërguarit të tubohen në kohën e caktuar – në të cilën ditë do të ndodhin të gjitha këto? Në Ditën e ndarjes vendimtare! [12] “Si mund ta mohoni Allahun, ndërkohë që keni qenë të pajetë e Ai ju dha jetën?! Pastaj Ai do t’ju bëjë të vdisni, më pas do t’ju ringjallë e, në fund, do të ktheheni tek Ai?! [13] “Thuaj: “Zoti ju ngjall, më pas ju vdes, më pas ju mbledh së bashku për Ditën e Gjykimit, rreth së cilës nuk ka asnjë dyshim” [14]

Për dijetarin hanefi Imam Tahavi-un (vd. 933), sunitë “besojnë në ringjalljen pas vdekjes dhe në shpërblimin për veprat (e një personi) në Ditën e ringjalljes, në shqyrtimin dhe llogarinë, në leximin e librit (në të cilin janë ruajtur veprat), në shpërblimin dhe dënimin, në urën e Siratit dhe Peshoren e veprave” [15]. Kredo hanbelite e cituar më parë është më specifike në këtë pikë: “Ura e Siratit është një realitet. Ajo është vendosur dhe shtrihet mbi xhehenem (ferr). Njerëzit kalojnë mbi të dhe paraqesha është përtej saj. Lutemi që Zoti të na mbrojë (gjatë kalimit të saj). Peshorja është një realitet. Në të do të peshohen veprat e mira dhe të këqija, ashtu siç Zoti dëshiron që ato të peshohen”. Po ashtu në këtë vepër flitet edhe për një haur dhe një sur (trombë, bori):

“Hauzi i Muhamedit (a.s.) është një realitet; bashkësia e tij do të shkojë për të pirë aty; në të gjenden enë prej të cilave ato do të pijnë...

Suri (boria) është një realitet. Israfil fryn në të dhe krijesat e gjalla vdesin. Më pas ai fryn për të dytën herë dhe ngjallen [dhe dalin] para Zotit të botërave për llogarinë dhe vendimin, shpërblimin dhe ndëshkimin, parajsën dhe ferrin.” [16]

“Sovraniteti atë ditë i takon Zotit. Ai do të gjykojë midis tyre [njerëzve] dhe ata të cilët kanë besuar dhe vepruar drejt do të jenë në kopshtin e kënaqësive. Ndërsa ata të cilët nuk besuan dhe mohuan shenjat Tona, për ta është rezervuar një mundim i turpshëm” [17]. Parajsa dhe ferri, shpjegon imam Tahaviu, “janë [që tani] të krijuara, e nuk do të zhduken apo pushojnë së ekzistuari asnjëherë. Zoti i krijoi ferrin dhe parajsën para krijimit [të botës], e më pas për secilin prej tyre krijoi njerëzit përkatës; disa ai i dëshiroi për parajsën, kjo falë hirit të Tij, e disa të tjerë ai i dëshiroi për ferrin, kjo falë drejtësisë së Tij” [18]

“...E do t’i shtyjmë të ligjtë në Xhehenem, si tufë e etur...[19]

...për ata që nuk besojnë janë përgatitur rroba prej zjarri, e mbi kokat e tyre do të hidhet ujë i valuar, me të cilin do t’u shkrihen ç’kanë në barqe dhe lëkura. Për ata ka kamxhikë prej hekuri. Sa herë, që do të përpiqen të dalin nga ankthi i zjarrit, do të rikthehen në të (e do t’u thuhet): “Shijoni dënimin me djegie të tmerrshme!” [20]

Njësoj siç vuajtjet e ferrit janë të përbëra nga flakët, flakërima dhe ujë të valuar, edhe kënaqësitë e parajsës marrin formën e kënaqësive tokësore, duke përfshirë edhe atë seksuale

“Ja përshkrimi i Xhenetit, që u premtohet të përkushtuarve (ndaj Allahut): një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata

do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre...” [21]

... Ata do të qëndrojnë në divane të stolisura me ar e gurë të çmuar, të mbështetur në to përballë njërit-tjetrit. Do t’u sillen rreth (për shërbim) djelmosha përherë të rinj, me kupa, ibrikë dhe gota me pije të kulluar, që rrjedh e prej së cilës nuk do t’u dhembë koka dhe nuk do t’u humbë mendja, e me fruta të cilat do t’i zgjedhin vetë dhe mish shpendësh që ua ka ënda. Për ata ka edhe hyrie symëdha, të ngjashme me margaritarët e ruajtur, si shpërblim për atë që kanë punuar. Aty nuk do të dëgjojnë biseda të kota, as fjalë gjynahesh, por vetëm fjalët “Paqe, paqe!” [22]

Këto kënaqësi janë rezultat i bujarisë hyjnore, i hirit dhe favorit të Zotit si dhe një shenjë e mëshirës së Tij. Megjithëkëtë thelbi dhe realiteti i këtyre përjetimeve mbetet, gjithsesi, të mbuluara me një lloj misteri. “Asnjë shpirt nuk e njeh se ç’mbahet e fshehur për ta nga ëndjet e syrit, si një shpërblim për atë që ata bënin [në dynja]” [23] Në një traditë të saktë profetike pohohet: “Zoti ka thënë: “Unë kam përgatitur për robërit e mi të drejtë atë që syri nuk e ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar, dhe zemra nuk e ka ndjerë” [24]

Kurani, gjithashtu, përmend edhe lloje të tjera kënaqësish në botën tjetër të cilat janë të një natyrë më të lartë se ëndjet ndjesore. “Ata që bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër (zijadeh)!” [25] Sipas opinionit të komentuesve të ndryshëm, kjo shtesë (zijadeh) në lumturinë e plotë qëndron në shikimin e Zotit. Dikush “i cili kërkon Fytyrën e Zotit të tij, më të Lartit. Dhe ai, me siguri, do të jetë i kënaqur!” [26] “Takimi” (*lika*) me Zotin dhe “kënaqësia” (*ridvan*) e Tij mund, gjithashtu, të kuptohet në lidhje me këtë kënaqësi përfundimtare. “Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos e shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!” “Allahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë.” “O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!”

Hedonizëm dhe soditje

Megjithëse versete të ndryshme kuranore sugjerojnë se jeta në parajsë është “pikënisja për një progres të ri, në të cilin njerëzit do të vazhdojnë të ngrihen në vende gjithnjë e më të larta” [28], përsëri janë të shumtë ata mysliman të cilët vazhdojnë ti shohin parajsën dhe ferrin si vende ku ato do të shpërblehen apo ndëshkohen fizikisht. Sipas përfytyrimit kuranor “atje do të keni çfarë t’ju dëshirojë zemra dhe çfarë të kërkonte, dhuratë e pasur prej një Zoti Falës dhe Mëshirëplotë.” [29] Për shumë mysliman, kjo nënkupton, ndër të tjera, përmbushjen e pritshmërive sensuale apo madje edhe të kënaqësive seksuale.

Ahmed Bahgat, një prej shkrimtarëve humorist bashkëkohorë më të mirë egjiptian, e ka ilustruar këtë në mënyrë të përsosur në veprën e tij “Kujtimet e Ramazanit”. Ai kujton një ditë kur ai po lëkundej për ta prishur agjërimin e tij: “Më pas mu shfaq parajsja, me lumenjtë e saj të verës, qumështit dhe mjaltit. Kështu që vendosa të bëja durim.” Gjithashtu ai kujton edhe ngjarjen e një shoku të tij, një pijaneci, i cili ishte duke i thënë atij: “A e di se çfarë më pikëllon në mendimin se unë nuk do të shkoj në parajsë?...lumenjtë e verës... Vetëm mendo për një çast: shishja të cilën ne e boshatisim çdo ditë zhduket përpara se ne të mbushim gotën, para se të fillojmë të kënaqim veten dhe para se të bëhemi tapë...Imagjino veten tënde përpara lumenjve të verës!” [30]

Ndërsa sa i përket Abdulvehab Bouhdiba, në veprën e tij të diskutueshme por të duartrokatur fort të titulluar *La sexualité en Islam*, ai nuk ngurron ta quaj vizionin islam për parajsën si një “orgazëm të pakufi”. Ai, veçanërisht, ka cituar pohimet e shkollarit të famshëm religjioz memluk Xhelaludin Sujuti (vd. 1505) sipas së cilit “një banor i parajsës do të martohet edhe me shtatëdhjetë hyrie përveç gruas së tij legjitime” dhe se “ereksioni i tij do të jetë i përhershëm” [31] Ka një farë kapadaillëku në analizën e këtij sociologu tunizian, duke qenë se ai e di shumë mirë se si seksualiteti dhe eskatologjia myslimane është gjykuar si “imorale” nga orientalistët, dhe, para tyre, nga gjenerata të tëra krishterësh duke nisur që nga Mesjeta. Kryemurgu i Kordovës Speraindeo shprehej, gjatë shekullit të nëntë, për parajsën e përshkruar në Kuran duke thënë: “*Hoc non erit paradisus, sed lupanar et locus sbcenissimus*” [32] Kohët e fundit, në mënyrë që ti ftoj myslimanët për të “rimenduar rreth origjinës hyjnore të Islamit”, apostati me origjinë pakistaneze Anwar Shaikh (lindur në vitin 1928) e ka reduktuar islamin në “seks dhe dhunë” dhe ka folur për “seksin pas vdekjes” si një “specialitet të Islamit”: Islami shfrytëzon dobësinë psikologjike të burrave për seks, dhe këshillon xihadin si rruga më e sigurt për të hyrë në parajsë, vendbanimi i seksit më luksoz” [33]

Pa dashur të bien në opinione kaq ekstreme, gjithsesi, një numër i caktuar mendimtarësh dhe mjeshtrash shpirtërorë klasik islam kanë shprehur shqetësimin apo rezervat e tyre rreth leximit tepër literal, materialist, apo hedonist të jetës tjetër të përshkruar në Kuran dhe në traditën profetike. Ose, ata janë përpjekur ti bëjnë këto përshkrime të “humbin” karakterin e tyre të diskutueshëm duke zhvilluar një hermeneutikë *ad hoc*. Kriticizmi i kryer nga Avicena nuk ka qenë i vetmi në llojin e tij. Fuqia me të cilën, në veprat e besimit të shkollave të ndryshme teologjike ortodokse (*sunite*) myslimane, është këmbëngulur jo vetëm për realitetin e urës së siratit, peshores, hauzit, etj, por gjithashtu edhe të vetë parajsës dhe ferrit, janë tregues që dëshmojnë për intensitetin e sulmeve me të cilat janë përballur këto aspekte fizike të jetës tjetër si dhe natyra trupore e shpërblimit dhe ndëshkimit në të. Sulme të cilat, duke nisur që nga periudhat e hershme të Islamit, janë kryer nga racionalistët mutezilitë dhe të tjerë si to. Në këtë këndvështrim është e mirënjohur mënyra se si e kuptonte Rabia el-Adevijeh, gruaja e famshme mistike e Basrës e shekullit të tetë, proverbin arab *El-Xhar Kablel Dar*,

“Komshiu është më parësor se shtëpia”: ajo ishte krejtësisht e interesuar për Zotin e jo për parajsën e Tij” [34]. Në një anekdotë që kronisti francez i Shën Louis-it, Joinville, i transmetoi mesjetës, Rabia përshkruhet si një grua e çmendur e cila sorollatet duke mbajtur në dorë një kovë me ujë dhe një pishtar. Meqenëse nuk dashuronte askënd tjetër përveç Zotit, ajo ishte e gatshme të shuante flakët e ferrit dhe ti vinte flakën parajsës. [35]

Një prej mjeshtrove më të rëndësishëm sufi të shekullit të nëntë, Ebu Jusuf el-Bistami, e deklaroi veten të gatshëm të vendoste tendën e tij në dyert e ferrit. “Unë e di”, shprehej ai “se nëse ferri do të më shohë mua do të ndaloj së djeguri dhe [në këtë mënyrë] unë do të jem një mëshirë për krijesat” Zoti pranon si dishepull të Tij vetëm “dikë që, në Ditën e Ringjalljes, do të ngrihet, do të marrë prej dore çdo monoteist të dënuar me zjarr, dhe do ta dërgoj atë për në parajsë”[36]

I njëjti Gazali i cili, në veprën e tij *Tehafetul*, dënoi mohimin që filozofët i bënë idesë së ringjalljes së trupave, në vepra të tjera të tij ka shquar tre lloje të ndryshme realizimi të premtimit apo kërcënimit eskatologjik të bërë nga profeti: ndjesor, imagjinar dhe intelektual. [37]. Për rrjedhojë ai nuk haste asnjë vështirësi me doktrinën, e zhvilluar nga Avicena, për karakterin imagjinar të ndjesive në botën tjetër, të cilën, sipas tij, do ta përjetonin njerëzit e thjeshtë. Në veprën e tij *Fejsal el-tefrika*, Imam Gazaliu ka shkruar aq larg sa të pranojë pesë mënyra të ekzistencës për realitetin e botës tjetër: konkrete, ndjesore, imagjinare, intelektuale dhe analogjike. [38]

Në një farë mënyre, kundërshtitë e ngritur shpesh kundër eskatologjisë së Kuranit dhe traditës profetike në Islam janë pjesë e një çështjeje më të gjerë të shfaqur, në mënyra dhe forma të ndryshme, midis mjeshtrove shpirtërorë po aq sa edhe midis shkollarëve racionalist, e cila vërtetë rreth qëllimit të vërtetë të religjionit. Përshkrimi i parajsës me të gjitha kënaqësitë ndjesore në të mund të konsiderohet nga shumë mendimtarë si një përfytyrim i destinuar ekskluzivisht për njerëzit e thjeshtë (*amma*) midis atyre që shoqëronin profetin, “myslimanët” të cilët në mënyrë naive apo të verbër i bindeshin ligjit religjioz (*shariat*) të përçuar nga profeti, universi mendor i të cilëve ishte thelbësisht i kufizuar në botën trupore (*ahism*) dhe veprat virtuozë (*amal*) të të cilëve motivoheshin nga frika e tyre ndaj zjarrit të ferrit, ose ishin një farë lloj tregtie (*tixharet*) e cila synonte të fitonte një shpërblim në të ardhmen (*axhr*). Në lidhje me vetet e tyre, këto mendimtarë në të shumtën e rasteve presin që të shohin dhe të sodisin (*mushaheda*) Zotin në botën tjetër dhe preferojnë më mirë këtë favor (*fadl*) se sa të jetojnë kënaqësitë sensuale trupore të parajsës. Ata e shihnin esencën e tyre njerëzore si vete (*nefs*) apo shpirtra (*ruh*) pastërtisht jomaterial. Ata besonin se përbënin një elitë (*khasa*) midis besimtarëve (*mu'min*), e cila zotëronte dije (*marifeh*) dhe gnosë (*irfan*). Ata mendonin se, në këtë mënyrë, mund të përjashtoheshin nga detyrimi fetar për tu bindur (*ta'a*) dhe kryer vepra të mira. Ata pohonin se kishin akses në sferën e të vërtetave të fshehta (*batin*) dhe të realitetit (*hakikah*) përtej kufizimeve të ligjit ekzotrik (*dhahir*). Ata pretendonin se ishin duke jetuar në një univers të shenjtërisë (*vilaja*) i cili mendohej se ishte më superior se sfera e profetësisë (*nubueh*), dhe se nuk kishin asnjë preokupim tjetër përveç dashurisë (*hub*) së pastër për Zotin.

Një lumturi gjithëpërfshirëse

Dallimi midis këtyre dy lloje religjioziteti është i pamash. Për teologun e madh nga Damasku, Ibn Tejmijen (vd. 1328), ky dallim përfshin një dikotomi dhe një përbuzje për profetin të cilat janë krejtësisht të papërshtatshme. Dimensionin e jashtëm dhe të brendshëm duhet gjithnjë të shoqërojnë njëra-tjetrën dhe jo të shihen si të ndara. Duke qenë një rrugë e mesme midis Hebraizmit dhe Krishterimit, siç shpjegon Ibn Tejmija, Islami është një shërbim ndaj Zotit (*ibada*) – ose ndryshe më shumë një *Gottesdienst* se sa një religjion- që përfshin si dashurinë (*hubb*) për Zotin ashtu edhe nënshtrimin e përunjur dhe të bindur (*dhul*) ndaj urdhërimeve dhe ndalesave hyjnore. [39] Dikush, praktika religjioze e të cilit nuk pasurohet nga spiritualiteti nuk mund të jetë një besimtar (mu'min) i vërtetë, ngjashëm dikush i cili pretendon se është duke jetuar një realitet të thellë religjioz pa ndjekur rrugën profetike nuk mund të quhet mysliman. [40] Sheriati (Ligji) i profetit është i plotë dhe i përsosur. Ai përbën rrugën më të mirë për tu afruar më Zotin, dhe është mjaftueshmërisht i gjerë dhe i thellë për të përfshirë shumëçka. Nuk ka asnjë arsye për ta kufizuar dobishmërinë e tij vetëm tek masat e rrjedhimisht as për të zhvilluar një alternativë apo rrugë të re për elitën. Edhe në rastin e jetës tjetër: është e gabuar të dallosh dhe të kundërvësh me njëra-tjetrën parajsën dhe shikimin e Zotit. Lumturia parajsore është gjithëpërfshirëse dhe nuk ka gjë tjetër përtej saj.

“I Lartësuar ka thënë: “Vetë ata që idhujtarët u luten, kërkojnë t’i afrohen Zotit të tyre, madje edhe më të afërtit, duke shpresuar mëshirën e Tij dhe duke iu frikësuar dënimit të Tij. Me të vërtetë, nga dënimi i Zotit tënd duhet të ruhet gjithkush” (Kuran 17:57). Ai gjithashtu ka thënë: “Vërtet, ata që besuan dhe ata që mërguan e luftuan në rrugë të Allahut, pikërisht ata shpresojnë në mëshirën e Allahut. Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë”. “Mëshira” (*rahmet*) e Tij është një fjalë e cila përfshin çdo të mirë, po ashtu edhe “dënimi” (*adhab*) i Tij përfshin çdo të keqe. Vendndodhja e mëshirës së pastër është parajsja, ndërsa vendndodhja e dënimit të pastër është ferri. Ndërsa kjo botë është vendndodhja e të dyjave së bashku. Madje edhe nëse shpresa i bashkëngjitet [vetëm] dëshirës për të hyrë në parajsë, përsëri parajsja është një fjalë e cila përfshin çdo lumturi dhe lumturi më e lartë është shikimi i Zotit [nga njerëzit]. Kështu që, në sahihun e Muslimit, raportohet nga Suhejbi ky nga Abdurrahman b. Ebi Lejla e ky nga profeti (a.s.) se: “Kur banorët e parajsës do të hynë në të, një lajmëtar do ti pyes ata: “O banorë të parajsës! Ju keni, nga Zoti, një premtim të cilin Ai dëshiron ta përmbush plotësisht për ju”. Ata do të thonë: “Cili është ai? A nuk na i ka zbardhur Ai fytyrat tona? A nuk na e bëri Ai peshoren tonë të lehtë? A nuk na e bëri Ai të mundur që të hynim në parajsë? A nuk na shpëtoi Ai prej zjarrit?”. Ai do të ngrejë perden dhe ata do ta shohin Atë. Ky është “plotësimi” [41] Në këtë mënyrë zhduket çdo hutim që gjendet në shprehjen e cila thotë: “Unë nuk të adhuroj Ty nisur nga dëshira për parajsën Tënde, e as nga frika ndaj zjarrit Tënd. Unë të kam adhuroar vetëm nga dëshira për të parë Ty” [42] Çdokush i cili thotë këtë shprehje është i mendimit, ai dhe kush e ndjek atë, se në atë që emërtohet parajsë nuk përfshihet asgjë tjetër vetëm se ngrënie dhe pirje, veshje dhe marrëdhënie seksuale, dëgjim dhe gjëra të ngjashme përmes së cilave dikush shijon gjërat e krijuara. Me mendimin e tij, në lidhje me këtë çështje, janë dakord edhe ata të cilët mohojnë të shikuarit e Zotit [nga njerëzit në parajsë]. Këto janë

Xhehmitët [43] ose ata të cilët e pranojnë të shikuarin e Zotit [në parajsë], por të cilët pohojnë se njerëzit nuk e shijojnë shikimin e Zotit në vetvete, siç është pretenduar kjo nga një grup juristësh [fukaha] islam. Këto [grupe] janë njëzëri në pohimin se në atë që emërtohet parajsë dhe botë tjetër nuk përfshihet asgjë tjetër përveç shijimit të gjërave të krijuara. Kjo është arsyeja përse duke dëgjuar fjalën e Zotit: “Disa nga ju dëshirojnë këtë botë, ndërsa të tjerë nga ju dëshirojnë botën tjetër. (Kuran 3:152), një prej shehlerëve të devijuar tha: “Ku janë ato që dëshirojnë Zotin?”. Në lidhje me këto fjalë të të Lartësuarit: “Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit”. (Kuran 9:111), dikush tjetër ka thënë: “Nëse vetja jonë dhe pasuria jonë na bën meritë për parajsën, po çfarë mund të themi për shikimin e Tij?” E gjitha kjo sepse ata janë të mendimit se, në parajsë, shikimi [i Zotit] nuk është i përfshirë.

E vërteta është se parajsja është banesa e lumturisë gjithëpërfshirëse dhe se lumturia më e lartë që njeriu gjen atje është të shikuarit e Zotit. Kjo është pjesë e lumturisë që rob i Zotit arrin në parajsë, njësoj siç na është përshkruar kjo nga shkrimet e shenjta. Ngjashëm, edhe njerëzit e ferrit, në lidhje me Zotin e tyre do të jenë nën perde kur të hynë në zjarr.

Duke qenë kështu, nëse ai që shpreh këto fjalë arrin të kuptoj atë që thotë, ajo që ai dëshiron të shpreh është vetëm kjo: “Madje edhe nëse Ti nuk ke krijuar asnjë ferr, e as një parajsë, përsëri dikush duhet domosdoshmërisht të të adhuroj të afrohet me Ty e të të shohë Ty”, ajo që kuptohet këtu me termin parajsë është ajo që krijesat mund të shijojnë. [44]

Unë do të falë gjithçka që vjen prej jush

Bouhidiba ka të drejtë kur thotë se “përsa i përket jetës *post mortem*, Islami ka pajisur me një vazhdimësi të mrekullueshme një vizion i cili është kaq i plotë dhe kaq i detajuar sa të përbëjë një kredo të vërtetë”. [43] Shekuj të tërë përpjekjesh teologjike dhe mistike kanë dërguar në një spektër shumë të gjerë interpretimesh në lidhje me këtë besim, që nga këndvështrimet më literalisht besnike ndaj Kuranit dhe traditës profetike deri tek ato më të dëmshmet. Një qasje “personale”- dhe padyshim qartësisht e përhapur dhe tradicionale- mund të përmbajë elementët e mëposhtëm:

Sprova personale në jetën tonë do të ketë një fund në një ditë të caktuar. “Unë nuk hezitoj në asgjë nga ato që bëj”, thotë Zoti në një hadith kuds, “më shumë se sa kur i marr shpirtin një besimtar. Ai e urren vdekjen dhe Unë urrej ti bëj dëm atij” [46] Sidoqoftë, siç përmendet edhe në Kuran, “çdo shpirt do të shijoj vdekjen”. “Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!” [47] Ky verset nuk duhet kuptuar si migrim (*tenasukh*) i shpirtit njerëzor brenda atij hyjnor.

Besimi në botën tjetër është një nga parimet themelore të religjionit, njësoj si besimi në Zotin e vetëm dhe në profetësinë e Muhamedit (a.s.). Ne nuk i mbijetojmë vdekjes për shkak të ndonjë esence të përhershme të shpirtit tonë, por vetëm fal vullnetit, fuqisë, providencës, drejtësisë dhe mëshirës së Zotit. “Siç ju ka krijuar së pari, ashtu do t’ju ringjallë”. “A nuk e shohin ata se Allahu, i Cili krijoi qiejt dhe Tokën pa u lodhur aspak në krijimin e tyre, është i Fuqishëm t’i ngjallë të vdekurit?” [48]

Qeniet njerëzore mbajnë përgjegjësi para Zotit të tyre. “Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë...” [49] Veprat e tyre do të peshohen në Ditën e Gjykimit dhe

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë”. [50] Etika, e cila qëndron në zemër të revelatës dhe profetësisë, nuk do të kishte asnjë kuptim pa llogarinë përfundimtare e cila të dërgon drejt shpërblimit apo ndëshkimit. Një gjë është e sigurt, gjithçka ndodh falë vullnetit, njohjes, vendimit dhe caktimit të Zotit. Gjithsesi, Zoti nuk e urdhëron dhe as e miraton të ligën, përkundrazi Ai urdhëron vetëm të mirën. Ndonëse të gjitha veprat tona, të mira apo të këqija qofshin, janë krijime të Zotit, përsëri ne kemi fuqinë ti përftojme ato dhe do të gjykojemi për to. [51] Ne nuk kërkojmë ta njohim këtë sekret të Zotit, por kemi besim tek drejtësia, urtësia dhe mëshira e Tij.

“Jeta tjetër është më e mirë për ata që e kanë frikë Allahun e s’bëjnë gjynahe. Juve nuk do t’ju bëhet asnjë fije padrejtësi”.

“Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti”. [53]

Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. [54]

“Unë godas me dënimin Tim kë të dua, ndërsa mëshira Ime përfshin çdo gjë”. [55]

“Nëse Ti i dënon ata – robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti”.

Ne gjithashtu pranojmë ndërmjetësimin e profetit në interes të mëkatarëve të mëdhenj të bashkësisë së tij. Ashtu siç shkruan edhe Gazali, “monoteistët do të nxirren nga ferri pas ndëshkimit. Si rrjedhojë, falë hirit të Zotit asnjë monoteist nuk do të mbetet përgjithmonë në zjarr.” [57] Megjithatë, “çështja e këtyre njerëzve i përket Zotit; nëse Ai dëshiron, Ai do ti dënoj ato, dhe nëse Ai dëshiron atëherë do ti falë ata” [58]

Në jetën e kësaj bote, religjioni- ritualet e tij si edhe *art de vivre* e tij-, përfshin tërë qenien tonë, me të gjitha aspektet e saj trupore, ndjesore, dhe emocionale si edhe dimensionet e tjera njerëzore, gjithçka e vendosur në vendin e duhur, gjë e cila është kusht për harmoninë dhe drejtpeshimin. Profeti (a.s.) ka thënë se ai dashuronte nga kjo botë tre gjëra: gratë, parfumin dhe lutjen, e cila ishte drita e syve të tij” [59] Duke mos parë asnjë kundërshti midis jetës seksuale dhe adhurimit, profeti (a.s) ndaloi çdo formë murgërie asketike apo beqarie. [60] Po ashtu edhe për botën tjetër, siç e shpjegon në mënyrë shteruese edhe Bouhidiba, “ne kemi ndjesinë se të shikuarit e Zotit [nga njerëzit] përbën në vetvete thelbin e kënaqësive të myslimanëve në parajsë. Por kjo nuk është e vetmja. Ajo duket si një zgjatim i kënaqësive të tjera, fizike në një farë mënyre, të cilat i janë premtuar të përzgjedhurve...Nuk është rastësi që ferri është vetmi, mosprani për të tjerët, me një fjalë mungesë dashurie. Në të kundërt, parajsa është dashuri totale, e plotë dhe e pafund. Ajo është unitet dhe pajtim me botën, me veten dhe me Zotin. Parajsa është pikësëpari pajtimi i njeriut me natyrën, d.m.th. me materien. Fakt i cili shpjegon shpërndarjen e elementëve material në parajsën mysliman. Parajsa është kënaqësi për të gjitha ndjenjat...Kuptimi i kënaqësive parajsore është se trupi duhet marrë seriozisht. Larg kërkimit të mospërmbushjes së dëshirave tona, Islami na mëson ti realizojmë ato më mirë...Islami në këtë mënyrë nuk është një ekonomizim i kënaqësive, por një valorizim mbindërgjegjësor i tyre. Sipas besimit tonë, integrimi i seksuales në të shenjtën është leksioni i madh dhe merita e madhe e vizionit islam për

botën tjetër.” [61] Ciladoqoftë natyra dhe modaliteti i saktë i tyre, çdo shpërblim apo ndëshkim [në botën tjetër] i cili nuk do përshtatej me gjendjen njerëzore, duke qenë krejtësisht material apo krejtësisht shpirtëror dhe intelektual, do të ishte absurd, sepse do të përbënte gjymtim të natyrës sonë. Anasjelltas, një rregullim, progres dhe hierarki i kënaqësive të parajsës, në varësi të gjendjeve të ndërgjegjes dhe zhvillimit shpirtëror, apo pritshmërive [të ndryshme] të banorëve të saj, nuk duhet përjashtuar. Tradicionalisht myslimanët kanë dalluar grada dhe vendbanime të ndryshme brenda parajsës. Mbi të gjitha, do të ishte shumë e çuditshme nëse shoqëria e profetëve, evliave, dhe e njerëzve të drejtë (*salih*), drejt të cilëve aspirojnë çdo mysliman [62], për të mos folur për shikimin e Zotit [nga ana e tyre], të mos ketë lënë asnjë ndikim mbi shpirtrat e tyre.

Siç ndodh shpesh, edhe këtë herë Avicena kishte të drejtë kur pohonte se nuk ekziston një e ashtuquajtur eskatologji shkencore. Por në vend të saj ekziston besimi në Zotin dhe në revelatën që iu përcoll profetit (a.s.), e cila, pa përjashtuar një farë frike për gjykimin dhe mërinë hyjnore kryesisht nënkupton sigurinë në premtimin e Zotit dhe shpresën në mëshirën e Tij. Pavarësisht nga kjo, bota tjetër i përket thelbësisht gajbit (të panjohurës). Siç e ka shprehur edhe Ibn Abasi, sahabi [dishepull] i mirënjohur i profetit: “Në parajsë nuk ka asnjë ushqim të kësaj bote, përveç emrave të tyre” [63] Siç e kemi thënë edhe më parë, në Kuran thuhet: “Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë”. [64] Ne mund të ndahemi dhe të polemizojmë me njëri-tjetrin rreth hipotezave dhe analizave tona eskatologjike, doktrinave, dogmave dhe besimeve, por “Sikur të donte Allahu, do t’ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t’ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni te Allahu e Ai do t’ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti” [65]. Ky ajet vlen jo vetëm për këtë çështje, por edhe për gjithçka tjetër.

“Bir i Ademit, për sa kohë ti do të vazhdosh të më thërrasësh dhe të shpresosh tek Unë, unë do të falë gjithçka që vjen prej teje [nga veprat e këqija] dhe nuk kam gajle aspak. O Bir i Ademit, edhe nëse veprat e tua të këqija do jenë të tilla sa të arrinë deri tek retë e qiellit dhe ti më kërkon falje, Unë do ti fal ato. O Bir i Ademit, edhe nëse ti më vjen mua me pothuajse krejt tokën me vepra të këqija e më pas më takon Mua duke mos më shoqëruar askënd [në adhurim], atëherë unë padyshim do të sjellë mbi ty falje pothuajse sa toka.” [66]

[*] Profesor Yahya Michot që nga viti 1998 ka qenë partner i qendrës së Oksfordit për studime Islam dhe e qendrës islame të lektorëve në fakultetin e teologjisë në Universitetin e Oksfordit. Fusha e tij e studimit është e përqendruar në mendimin klasik mysliman, kryesisht mbi Avicenën (vd. 1037 e.r.s.). Ai ka studiuar burimet e Avicenës dhe ndikimin e tij mbi islamin sunit. Kjo gjë e ka dërguar atë drejt shfaqjes së një interesi gjithnjë e më të madh për Ibn Tejmijen (vd. 1328) dhe kohën e Memlukëve.

Përktheu: Rezart Beka

Referenca

- [1] D.m.th. fjalëpërfjalshmëria e pohimeve kuranore rreth botës tjetër.
- [2] D.m.th. një jetë tjetër trupore.
- [3] D.m.th. shpirtërore më shumë se sa trupore.
- [4] Avicena, Risala Adhawija, në Y. Michot, 'A Mamluk Theologian's Commentary on Avicenna's Risala Adhawija: përkthim i pjesshëm i Dar et-Tearud të Ibn Tejmijes, me parathënie, shënime, dhe apendikse, pjesa e I, Journal of Islamic Studies 14 (2003), f. 149-203 (177).
- [5] Rreth profetologjisë së Avicenës shih Y. Michot, La destinée de l'homme selon Avicenne: Le retour à Dieu (ma'ad) et l'imagination (Louvain: Peeters, 1986), f. 35-43.
- [6] Avicena, Adhawija, në Y. Michot, 'Mamluk Theologian's Commentary', f. 177.
- [7] Rreth doktrinës së Avicenës për karakterin imagjinar të jetës tjetër për besimtarët e thjeshtë, shih Michot, Destinée, f. 43-53.
- [8] Al-Ghazali, Tehafut, cituar në Michot, Destinée, f. 214
- [9] Në lidhje me eskatologjinë kuranore, unë zakonisht ndjek M.M. Ali, The Religion of Islam: A Comprehensive Discussion of the Sources, Principles and Practicies of Islam (Cairo: National Publication and Printing House [, 1972?]), f. 264-314; dhe D. Masson, Monothéisme coranique et monothéisme biblique: Doctrines comparées (Paris: Desclée De Brouëer, 1976), f. 679-764. Shih gjithashtu edhe J.I. Smith dhe Y.Y. Haddad, The Islamic Understanding of Death and Resurrection (Oxford: Oxford University Press, 2002).
- [10] Kuran 80:21-22 dhe 23:100.
- [11] Ibn Farra, cituar në W.M. Watt, Islamic Creeds: A Selection (Edinburg: Edinburg University Press, 1994), f. 35.
- [12] Kuran 77: 7-13
- [13] Kuran 2:28
- [14] Kuran 46:26
- [15] Imam Tahavi, cituar në Watt, *Creeds*, f. 54

- [16] Ibn Farra, cituar në Watt, *Creeds*, f. 35-36
- [17] Kuran 22:56-57
- [18] Tahaviu, cituar në Watt, *Creeds*, f. 54
- [19] Kuran 20:86
- [20] Kuran 22: 19-22
- [21] Kuran 47:15
- [22] Kuran 56:15-26
- [23] Kuran 32:17
- [24] Buhari, cituar në W.A. Graham, *Divine Word and Prophetic Word in Early Islam: A Reconsideration of the Sources, with Special Reference to the Divine Saying or Hadith Qudsi* (The Hague and Paris: Mouton, 1977), f. 117
- [25] Kuran 10:26
- [26] Kuran 92:20-21
- [27] Kuran 18: 110; dhe 89:27-30
- [28] Ali, *Religion*, f. 303.
- [29] Kuran 41:31
- [30] A. Bahgat, *Mémoires de Ramadan (Mudhakirat sa'im)* (Trans. Y. Michot; Paris: L'Harmattan, 1991), f. 27-28.
- [31] A. Bouhidiba, *La sexualité en Islam* (Paris: Presees Universitaires de France, 1975), f. 91 dhe 96-96.
- [32] Cituar në Norman Daniel, *Islam and the West: The Making of an Image* (Edinburgh: Edinburgh University Press, 1960), f. 126.
- [33] A. Shaikh, *Islam: Sex and Violence* (Cardiff: Principality Publishers, 1999), f. 91. Rreth këtij autori shih faqen e internetit www.secularism.org/skeptic/anëar.htm.
- [34] Shih R. Caspar, *Cours de mystique musulmane* (Rome: Pontifical Institute of Arabic Studies, 1976), f. 37
- [35] Shih Casper, *Cours*, f. 38
- [36] Shih Casper, *Cours*, f. 58

[37] Shih Michot, Destinée, f. 212

[38] Shih S.A. Jackson, On the Boundaries of Theological Tolerance in Islam: Abu Hamid Al-Ghazali's Faysal al-Tafriqa Bayna al-Islam ëa al-Zandaqa (Karachi: Oxford University Press, 2002), f. 94-96.

[39] Shih Ibn Tejmije, faqe të përkthyer nga Y. Michot, 'Textes spirituels d'Ibn Teymiyya, XVI: La réalité de l'amour (*mahhaba*) de Dieu et de l'homme (suite)', Le Musulman 29 (1998), f. 20-25 (20)

[40] Ibn Taymiyya, Mexhmua Fetaua (ed. A.R. b. M. Ibn Kasim; 37 volume; Rabat: Maktabet el-marif, 1981), VIII, f. 316; përkthimi në veprën time të ardhshme Ibn Taymiyya: La sang et la foi d'al-Hallaj (Paris: Elbouraq, 2006).

[41] Shih Muslim, Al-Sahih, Iman, bab 80 (8 vëllime, Constantinople: n.p., AH 1334/1916), I, f. 112; Ibn Hanbel. Al-Musnad (6 vëllime; Kajro: Al-Babi l-Halabi, AH 1313/1896), IV, f. 332. Rreth "plotësimit", shih Kuran 10:26.

[42] Krahaso thënien e Rabia el-Adevijeh (vd. Basra, 801): "Je ne L'ai adoré ni par crainte de Son Enfer, ni par amour de Son Paradis. Car j'aurais été alors comme un mauvais serviteur qui travaille quan dil a peur ou quand il est récompense. Mais je L'ai adoré par amour et par passion de Lui" (Rabbi'a: Chant de la recluse [trans. M. Oudaimah dhe G. Pfister; Paris: Arfuyen, 1988], f. 9). Shih gjithashtu Ebu Jezid el-Bistami (vd. 874 ose 857): "J'ai vu les hojmes ici-bas prendre plaisir à boire, à manger, à convoler. De même fans l'au-delà. J'ai mis alors mon plaisir en son invocation ici-bas, en Sa contemplant fans l'au-delà" (Les dits de Bistami: Shatahat [trans. A Meddeb; Paris: Fayard, 1989], f. 173-74, nr. 423).

[43] Ndjekësit e shkollës teologjike të Xhehm b. Safvan, Ebu Muhriz (vd. 746); Shih W.M. Watt, 'Djam b. Safëan' dhe 'Djahmiyya', në Encyclopedia of Islam (11 vols.; Leiden: E.J. Brill, 1986-2002), II, f. 388.

[44] Ibn Taymiyya, Majmu el-Fatawa, pakthyer nga Y. Michot, 'Textes spirituels d'Ibn Teymiyya. XV: La realite de l'amor (mahabba) de Dieu et de l'homme", Le Musulman 28 (1996), f. 24-27 (24-25)

[45] Boudiba, Sexualité, f. 99

[46] Al-Bukhari, quoted in Graham, *Divine Eörd*, f. 173.

[47] Kuran 3:185 dhe 2:156.

[48] Kuran 7:29 dhe 46:33.

[49] Kuran 67:2.

[50] Kuran 99:7-8.

[51] Shih besoren e Eshariut në Watt, *Creeds*, f. 42-44.

[52] Kuran 4:77.

[53] Kuran 39:53.

[54] Kuran 4:48.

[55] Kuran 7:156.

[56] Kuran 5:118.

[57] Cituar në Watt, *Creeds*, f. 44.

[58] Eshariu, cituar në Watt, *Creeds*, f. 44.

[59] Rreth këtij raportimi shih: Ibn Hanbel, *el-Musned*, III, f. 128, 199 dhe 285.

[60] Rreth thënies që i atribuohet profetit: Nuk ka murgëri në Islam”, shih L. Massignon, *Essai sur les origines du lexique technique de la mystique musulmane* (Paris: J. Vrin, 1954), f. 145-53. Shih, gjithashtu, edhe Y. Michot, ‘Un célibataire enduri et sa maman: Ibn Taymiyya (m. 728/ 1328) et les femmes’, në *La femme dans les sociétés orientales* (ed. C. Cannuyer; Brussels: Société Belge d’?tudes Orientales, 2001), f. 165-90 (182-87).

[61] Bouhdiba, *Sexualité*, f. 102-106.

[62] Shih, p.sh., lutjen e Jakubit (Jozefit) në Kuran, kapitulli 12 verseti 101: “Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër)!”

[63] Shih Ali, *Religion*, f. 292.

[64] Kuran 32:17.

[65] Kuran 5:48.

[66] Hadith kudsî; shih Imam Neveviu (vd. 1277), *The Complete Forty Hadith* (trans. A. Clarke; London: Ta-Ha Publishers, AH 1419/ 1998), f. 145.

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi